



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 51

Datë: 02. 10. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Binak Vishaj, Ercan Spat, Bajram Ljatifi dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ.

Nexhmi Haxhiu, drejtor i Prokurimit.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1.Hyrje: Valdete Daka, kryetare e KQZ –së.

- *Diskutimi lidhur me vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për tenderin e Informimit Publik të Zgjedhjeve Lokale të 22 tetorit, 2017*

2. Shqyrtimet dhe rekomandimet e Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë

3. Të ndryshme

1.Hyrje: Valdete Daka, kryetare e KQZ –së

Valdete Daka: Kemi kurom... Në këtë mbledhje, e kemi një situatë të ndërlikuar rreth informimit publik, rreth tenderit për zgjedhjet lokale i cili, është anuluar nga OSHP. Tash, kemi një situatë kur duhet të vendosim se çka të bëjmë më tutje... Kryeshef, a mundesh me na njoftue se si qëndron puna...

Enis Halimi: Ne kemi proceduar me këtë tender, si edhe me tenderët e tjerë, sipa planit të prokurimit, në muajin mars 2017. Mëpastaj, u ndoshëm në zgjedhje të parakohshme dhe për disa ditë u shty procedura e vlerësimit të tij. Vlerësimi ka përfunduar në qershor 2017 dhe mëpastaj ka filluar faza e ankesave, të cilat na kanë shpër deri në këtë kohë. Ka pasur një Komision vlerësimi për dhënjen e këtij tenderi. Së pari, tenderi nga komisioni ynë i është ndarë MDA-së. Mirëpo, pas ankesës së „2B“ –së, e cila ka ankuar për llotin e parë të tenderit, si njëri prej pjesëmarrësve në tender, i cili nuk është pajtuar me punën e komisionit, lënda ka kaluar në OSHP. Pas shqyrtimit, OSHP i ka dhënë të drejtë kësaj kompanie, dhe kështu e ka anuluar vendimin tonë dhe e ka kthyer në rivlerësim.

Tenderi, ka qenë i ndarë në dy llot. Ne e kemi mënjeluar komisionin e parë, dhe kemi themeluar komisionin tjetër, i cili ka bërë rivlerësimin. Dhe, normalisht komisioni ia ndanë „2B“ –së tenderin, sepse ky edhe ka qenë rekomandimi i OSHP-së. Vazhdimisht, ne kemi bërë përpjekje për ta sqaruar rastin dhe kemi pasur disa takime me OSHP-në, ku kam marrë pjesë edhe unë. Por, nuk e kemi zgjidhur rastin. OSHP, ia ka njohur validitetin ankesës së „2B“ –së dhe, ka rekomanduar që të procedohet sipas njoftimit për dhënie të kontratës me të cilën, shpallet fitues „2B“ për Loton I. Në ndërkohë, ka bërë ankesë edhe ish kompania fituese MDA së cilës, OSHP ia ka njohur të drejtën që ta fitojë Loton II.

Kështu, janë stërgjatur procedura dhe, ky tender tash e ka humbur objektin e kontratës sipas specifikave të strategjisë së Informimit Publik, për shkak se tashmë kanë kaluar disa faza të procesit zgjedhor. Për këtë gjë, edhe me shkrim por edhe verbalisht e kemi njoftuar OSHP-në, para se ata ta marrin vendimin e fundit.

Jemi në një fazë krejtësisht paradoksale, dhe prej nesh varet: a të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale, apo të vazhdojmë me hapa të tjerë siç kemi vepruar deri më tani...?

Valdete Daka: A mund të na shpjegohet se, a kemi ndonjë pengesë që ta implementojmë një pjesë të projektit, si është situata...A mund të na shpjegohet më detalisht...?

Nexhmi Haxhiu, drejtor i Prokurimit i bëri shpjegimet procedurale lidhur me këtë tender. Ai, e shpjegoi detajisht gjendjen, duke dhënë informacione lidhur me gjendjen – pozicionin nga aspekti procedural në të cilën, ndodhet ky tender. Po ashtu, z. Haxhiu, i paraqiti kushtet dhe mundësitë rreth këtij tenderi, dhe potencoi faktin se, mund të fillohet me implementimin e tij, duke qenë se operatori, do të paguhet vetëm për ato produkte që do t'i prodhojë dhe jo për shumën totale të projektit....

Ai, theksoi se, mbi të gjitha, vendimi i OSHP-së duhet të zbatohet...

Ilir Gashi: Nëse ne nuk do të dëmtohem, nëse nuk ka pengesa ligjore që të vazhdohet me pjesën e mbetur të informimit, të vazhdojmë sepse me të vërtetë do të gjendemi para një kaosi. Njerëzit, votuesit, do të mbeten pa njohuritë se si të votohet. Unë jam për..., nga aty prej ku mund të fillohet, edhe ashtu jemi shumë vonë...

Sami Hamiti: Nëse nuk ka reperkusione ligjore, materiale sepse janë shumë specifika, pra nëse mundën me u nda specifikat e prodhimit, shikojeni mundësinë: pse jo...! Por, dyshoj se a mundet...! Shiheni se,

kompania madandej mundet me e kërkue krejt vlerën e projektit, vlerën e kontratës...Nëse, mundet që kjo mos me ndodh, filloni...Por, bisedoni me kontraktorin...

Në fund, anëtarët e KQZ-së, u dakorduan që:

- Të saktësohet vlera e produkteve që mund të realizohen në kohën e mbetur,
- Të takohet Këshilli për Mbikqyrje të Informimit Publik ditën e nesërme në orën 11 dhe në takim të specifikohet vlera e produkteve që kanë mbetur, dhe që mbi këtë bazën e kësaj të vendoset se a mund të hyhet në marrëdhënie kontraktuale, apo nuk mund të hyhet në një marrëdhënie të tillë.

2. Shqyrtimet dhe rekomandimet e Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë

Valdete Daka: Kemi diskutuar edhe në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, dhe të shohim se si të dakordohemi për disa vizita, dhe obligime që i kemi si KQZ...Në radhë, janë zgjedhjet Lokale në Maqedoni, dhe në mbledhje të këshillit kemi vendosur për t'i vëzhguar këto zgjedhje. Do të shkojmë 6 veta nga KQZ, dhe 3 nga Sekretariati. Nuk jemi marrë vesh për emrat nga Sekretariati, mirëpo nga KQZ, kemi vendosur që në Maqedoni të shkojnë: Bajram Ljatifi, Valdete Daka, Ergit Qeli, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, dhe Betim Gjoshi.

Në Slloveni, lidhur me mbikqyrjen e prodhimit të Fletëvotimeve, u vendos që të shkojnë në raundin e parë: Eshref Vishi, Ercan Spat dhe Enis Halimi (SKQZ). Kurse, në raundin e dytë: Ilir Gashi dhe Binak Vishaj dhe një nga Sekretariati (që do të caktohet së shpejti)

Në Republikën e Koresë, udo të udhëtoj Valdete Daka.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
